



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.335/2021

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2610/2019 të datës 15.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.478/2019 të datës 20.08.2019 të parashtruar nga ankuesja të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson Avokat

ne adresë rruga "Luan Haradinaj", nr.104 në Prishtinë, kundër Vendimit me numër 01Nr.2510 të datës 14.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Rahovecit, në çështjen juridike "masë disiplinore-ndërprerjeje e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 31.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.478/2019 e datës 20.08.2019 e parashtruar nga ankuesja e shqyrtuar sipas Aktgjykimit A.nr.2610/2019 të datës 15.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

II. Shfuqizohet Vendimi me numër 01Nr.2510 i datës 14.08.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Rahovecit dhe Vendimi me Nr. prot:865 i datës 08.07.2019 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Rahovecit.

III. Obligohet Kryetari i Komunës së Rahovecit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesen

në vendin e punës Drejtoresh e Shkollës së Mesme të Lartë Profesionale "Selajdin Mullaabazi-MICI" sipas Kontratës së punës për kohë të caktuar të datës 04.12.2017 më të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me marrëdhënien e punës dhe duke bërë kompensimin e të gjitha pagave nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankueses e punësuar sipas Kontratës së punës për kohë të caktuar të datës 04.12.2017 në pozitën "Drejtoresh e Shkollës së Mesme të Lartë Profesionale Selajdin Mullaabazi-MICI" në Komunën e Rahovecit, më datë 18.06.2019 Drejtori i Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Rahovecit ka iniciuar procedurë disiplinore për shkelje të rënda të detyrave të punës, ku në fletëparaqitje ka theksuar që: *"Sepse më datë 14.06.2019, gjatë mbajtjes së Testit të Maturës në SHMLP "Selajdin Mullaabazi-Mici" ka reaguar ashpër ndaj zyrtarëve të policisë së Kosovës, duke i penguar ata në kryerjen e detyrave dhe duke i fyer dhe ofenduar ata. Drejtori i DKA-së ka pranuar një raport të shkruar nga Policia e Kosovës, më 17.06.2019, në të cilin janë raportuar të gjitha fjalët ofendues që ka përdorur znj. Vjollca Vuçitërna ndaj zyrtarëve të Policisë së Kosovës. Kësaj fletëparaqitje i është bashkangjitur edhe Raporti Informues i Policisë së Kosovës-Stacioni në Rahovec, i datës 14.06.2019 i cili është protokolluar më 17.06.2019 me numër protokollit 744".*

Komisioni Disiplinor i Komunës së Rahovecit, më datë 08.07.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. prot:865 me të cilin ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore *"ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil"*.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr. prot:865 të datës 08.07.2019 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Rahovecit, më datë 19.07.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Rahovecit.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Rahovecit, më datë 14.08.2019 ka nxjerr Vendim me numër 01Nr.2510 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses duke e vërtetuar vendimin e Komisionit Disiplinor.

Ankuesja kundër Vendimit me numër 01Nr.2510 të datës 14.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Rahovecit, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.08.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3663/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 27.08.2019 ankesën e ankueses e ka proceduar tek Komuna e Rahovecit për përgjigje në ankesë. Komuna e Rahovecit më datë 06.09.2019 ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 01.19.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 15.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2610/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 04.11.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 26.09.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova:
Ankesën me numër protokolli 3663/2019 të datës 20.08.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 16.08.2019; Procesverbalin e datës 24.06.2019, 01.07.2019; Vendimin me Nr. prot:865 të datës 08.07.2019 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Rahovecit; Ankesën e datës 15.07.2019 të ankueses e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Rahovecit; Vendimin me numër 01Nr.2510 të datës 14.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Rahovecit; E-mailin e datës 23.06.2019; Format e raportimit të monitoruesit të maturës të datës 14.06.2019; Informim i datës 17.06.2019 nga Deklaratë e datës 18.06.2019 nga Këshilli i nxënësve të klasave të XII-ta të SHMLP "Selajdin Mullaabazi-Mici"; Ankesë e datës 18.06.2019 nga Deklaratën e datës 24.06.2019 nga Raportimi i datës 21.06.2019 nga Kryetari i Këshillit të Prindërve Ankesën e datës 24.06.2019 nga Deklaratën e datës 21.06.2019 nga Deklaratën e e datës 19.06.2019; Deklaratën e datës 19.06.2019 nga Kelmendi; Deklaratën e datës 24.06.2019 nga Deklaratën e datës 17.06.2019 nga Deklaratën e datës 19.06.2019 nga Deklaratën e datës Deklaratën e datës Deklaratën nga Deklaratën e datës 21.06.2019 nga Deklaratën e datës 21.06.2019 nga kujdestarët e klasave të XII-ta dhe Procesverbal i datës 14.08.2019; Kërkesë për marrjen e shkresave të

lëndës disiplinore Nr. 747/2019 e datës 10.07.2019 nga ankuesja; Ftesën e datës 18.06.2019 për ankuesen dhe Vendimin me Nr. protokoli 453 i datës 01.12.2017; Kontratën e Punës për kohë të caktuar e datës 04.12.2017; Vendimin e datës 19.06.2019 për caktimin e Komisionit Disiplinor AD-HOC për Arsim; Fletëparaqitje e datës 18.06.2019 për Komisionin Disiplinor; Ftesën e datës 25.06.2019 për Deklaratën e Isa Durguti e datës 18.06.2019; Komunikimet telefonike; Fotot; E-mailin e datës 18.06.2019 nga për Vendimin me Nr.509/01B të datës 29.11.2018 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Përgjigjen në ankesë e datës 06.09.2019; Aktgjykimin A.nr.2610/2019 të datës 15.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Njoftimin e datës 01.01.2019 për ankuesen; Kërkesën për informata zyrtare e datës 22.02.2021 dhe përgjigjen e datës 22.02.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankueses *është e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, shqyrtoi pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se: vendimi i Komisionit Disiplinor është i nxjerr aty për aty në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ngase nuk lejohet formim i komisionit disiplinor AD-HOC pasi që i njëjti ka mandat dy vjeçar; nuk është bërë fare shqyrtimi i shkeljes eventuale disiplinore nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë duke mos kontaktuar fare me shkelësin; policia nuk ka pas asnjë të drejtë dh asnjë vendim për kontrollim të nxënësve pasi sipas vendimit të MASHT për organizimin e provimit përgjegjës është drejtori i shkollës dhe administruesit të provimit të maturës; në asnjë formë nuk kam bërë shkelje pasi që reagimi ka qenë norma këtë e dëshmon edhe deklarata e policit në seancë të komisionit disiplinor të datës 24.06.2019; Komisioni Disiplinor në mënyrë të gabuar dhe tërësisht në kundërshtim me legjislacionin ka shqiptuar masën disiplinore; Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e refuzimit të ankesës ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që vendimi i Komisionit Disiplinor është i nxjerr aty për aty në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ngase nuk lejohet formim i komisionit disiplinor AD-HOC pasi që i njëjti ka mandat dy vjeçar, ka konstatuar që Komuna e Rahovecit më datë 19.06.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. protokoli 01/239/19 me të cilin ka bërë caktimin e Komisionit Disiplinor AD-HOC për Arsim, në këtë rast institucioni nuk mund të formoj komision disiplinor AD-HOC për Arsim pasi që Komisioni Disiplinor formohet me mandat dy (2) vjeçar dhe është i njëjti për të gjithë nëpunësit civil që ka ai institucion dhe i njëjti komision duhet të shqyrtoj të gjitha rastet disiplinore e jo të bëhet ndarje nëpër sektor të veçantë, me këtë rast Komuna e Rahovecit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 70 paragrafit 3 të Ligjit Nr.

03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit disiplinor janë nga radhët e nëpunësve civilë me përgatitje superiore shkollore, emërohen në periudhë dy (2) vjeçare, me mundësi vazhdimi, dhe duhet të pasqyrojnë diversitetin e shoqërisë kosovare, duke përfshirë sidomos diversitetin gjinor"*, mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankueses është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që nuk është bërë fare shqyrtimi i shkeljes eventuale disiplinore nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë duke mos kontaktuar fare me shkelësin, ka konstatuar Komuna e Rahovecit respektivisht Drejtori i Drejtorisë së Arsimit pasi që ka pranuar informimin e datë 14.06.2019 nga Toger të protokolluar në Komunën e Rahovecit më datë 17.08.2019, në të cilin ka theksuar që ankuesja ka përdorur fjalë: *"Jeni bo si policia e shkive, duke e kontrolluar nxënësit nëpër gjepa të pantallonave si me hy në burgje"* dhe me të cilin është kërkuar të merren *masa ligjore dhe disiplinore* ndaj ankueses, mirëpo Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Rahovecit si udhëheqës i drejtpërdrejtë i ankueses në bazë të provave të lëndës nuk ka marr asnjë veprim për të konstatuar se shkelje eventuale e ankueses është shkelje e lehtë apo e rëndë e detyrave të punës siç përcaktohet me dispozitat e nenit 11 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Udhëheqësi i drejtpërdrejt do të mbledhë dhe do të shqyrtojë çdo dëshmi që ka lidhje rastin e paraqitur për shkelje e dyshuar të nëpunësit civil"*, dhe po ashtu nuk ka asnjë dëshmi në provat e lëndës që udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankueses të ketë ftuar ankuesen për të biseduar lidhur me rastin, siç përcaktohet dispozitat e nenit 11 paragrafin 3 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Intervistimi sa më shpejtë që është e mundur pas lajmërimit të rastit të dyshuar, por jo më vonë se tri (3) ditë pune, duke siguruar se shkelësi i dyshuar është njoftuar 24 orë më herët"*, rrjedhimisht pretendimi i ankueses është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që policia nuk ka pas asnjë të drejtë dhe asnjë vendim për kontrollim të nxënësve pasi sipas vendimit të MASHT për organizimin e provimit përgjegjës është drejtori i shkollës dhe administruesi i provimit të maturës, ka konstatuar që në bazë të Vendimit me Nr.509/01B të datës 29.11.2018 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë respektivisht pikës 2 të tij theksohet që *"Sekretari i përgjithshëm i MASHT, Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) dhe drejtorët e institucioneve të arsimit parauniversitar ngarkohen me zbatimin e këtij Vendimi dhe janë përgjegjës për marrjen e masave sipas legjislacionin në fuqi në rast të shkeljes së tij"*, në kuptim të kësaj askush nuk ka mandat të ftoj policinë që të bëjë kontrollimin e nxënësve me rastin e nënshtrimit të testit të maturës përveç çështjes së mbajtës së rendit dhe qetësisë, për më tepër në bazë të raportimit të monitoruesve të maturës nga znj. dhe znj. nuk është lajmëruar ndonjë shkelje gjatë testimit apo përdorim i telefonave që ka mundur të prish procesin, kështu që reagimi i ankueses në cilësinë e drejtoreshës së Shkollës së Mesme të Lartë Profesionale "Selajdin



Mullaabazi-MICI" e cila ka reaguar ndaj kontrollimit të nxënësve gjatë testit të maturës nga një polic i gjinisë mashkullore e aq më tepër kontrollimi i nxënësve të gjinisë femërore nga i njëjti polic nuk ka qenë reagim tendencioz, sepse në bazë të provave të lëndës ka reagim me shkrim si nga nxënësit, kujdestarët e klasave, këshilli i nxënësve dhe punëtorët e tjerë të Shkollës së Mesme të Lartë Profesionale "Selajdin Mullaabazi-MICI" në Komunën e Rahovecit për kontrollin që ju është bërë nxënësve nga polici duke e konsideruar që ka ndodhur si asnjëherë më parë me të cilin nxënësve ju është shkaktuar stres.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që në asnjë formë nuk kam bërë shkelje pasi që reagimi ka qenë normal këtë e dëshmon edhe deklarata e policit në seancë të komisionit disiplinor të datës 24.06.2019, ka konstatuar që iniciimi i procedurës disiplinore ndaj ankueses është bërë në bazë të informimit të datës 14.06.2019 të protokolluar në Komunën e Rahovecit më datë 17.08.2019 të Togër i cili ka akuzuar ankuesen që i është drejtuar me fjalë: *"Jeni bo si policia e shkive, auke e kontrolluar nxënësit nëpër gjepa të pantallonave si me hy në burgje"* për të cilën deklaroi që fyerja i është bërë në prezencë të shumë profesorëve dhe stafit tjetër, ndërsa përveç deklaratës me shkrim të togër z. dhe deklaratës së znj. në bazë të deklaratave si në vijim: Deklaratës së datës 18.06.2019 nga Këshilli i nxënësve të klasave të XII-ta të SHMLP "Selajdin Mullaabazi-Mici"; Ankesës së datës 18.06.2019 nga Deklaratës së datës 24.06.2019 nga Raportimit të datës 21.06.2019 nga Kryetari i Këshillit të Prindërve Ankesës së datës 24.06.2019 nga Deklaratës së datës 21.06.2019 nga Deklaratës së e datës 19.06.2019; Deklaratës së datës 19.06.2019 nga Deklaratës së datës 24.06.2019 nga Deklaratës së datës 17.06.2019 nga Deklaratës së datës 19.06.2019 nga Deklaratës së datës Deklaratës së Deklaratës së Deklaratës së Deklaratës së Deklaratës së Deklaratës së datës 21.06.2019 nga Deklaratës së datës 21.06.2019 nga kujdestarët e klasave të XII-ta dhe nuk është raportuar për ndonjë fyerje nga ankuesja në drejtim të policisë kjo vërtetohet edhe në bazë të procesverbalit të datës 24.06.2019 të Komisionit Disiplinor, ku pjesëtari i Policisë së Kosovës z. në cilësinë e dëshmitarit ka deklaruar se: *"ndaj meje nuk ka pas ofendime nga drejtoresha ndërsa në bazë të procesverbalit të datës 01.07.2019 të Komisionit Disiplinor deklarata e në këtë takim të komisionit dhe ajo e deklaruar në bazë të informimit të datës 14.06.2019 është kontroverse, sepse në takimin e Komisionit Disiplinor ka deklaruar që: "...qka je tu fol drejtoreshë e ki ba një krahasim me policinë e shkive, se sjemi ardhë në baza vullnetare por kemi ardhur me kërkesë të MASHTI për mbarëvajtjen e procesit të testit të maturës, aty prezent ka qenë edhe përfaqësues e MASHT-it ndërsa në informimin e datës 14.06.2019 deklaroi se: "... dhe mu drejtua me fjalë në prezencë të shumë profesorëve dhe stafit tjetër që ishin prezent në korridorë të shkollës..."*, Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të

ankueses e cila pretendon që Komisioni Disiplinor në mënyrë të gabuar dhe tërësisht në kundërshtim me legjislacionin ka shqiptuar masën disiplinore, ka konstatuar që Komisioni Disiplinor me rastin e shqyrtimit të rastit të ankueses nuk ka shqyrtuar provat në mënyrë të drejtë, kështu që Vendimin me Nr. prot:865 të datës 08.07.2019 e ka nxjerr në kundërshtim me dispozitat e nenit 66 paragrafit 1 dhe 4 nën paragrafit 4.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"1.Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil. Rastet e shkeljeve jashtëzakonisht të rënda përcaktohen me akt nënligjor.4. Për shkelje të rënda-serioze shqiptohen masat disiplinore si në vijim: 4.3. ndërprerja e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil nga komisioni disiplinor"*, si dhe në kundërshtim me nenin 8 paragrafit 1 nën paragrafit 1.4 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil pasi që nuk ka pasur vlerësim të drejtë të gjendjes faktike dhe juridike ku arsyetimin e ka dhënë në mënyrë jo profesionale dhe në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtshënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij"*, mbi këtë bazë pretendimet e ankueses janë të bazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e refuzimit të ankesës ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Rahovecit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 01Nr.2510 të datës 14.08.2019 me të cilën ka refuzuar ankesën e ankueses duke e vërtetuar vendimin e Komisionit Disiplinor, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike, kështu që pretendimi i ankueses është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që Komuna e Rahovecit është e obliguar që ankuesen _____ kthej në vendin e punës "Drejtoresh e Shkollës së Mesme të Lartë Profesionale Selajdin Mullaabazi-MICI" sipas Kontratës së punës për kohë të caktuar të datës 04.12.2017 më të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me marrëdhënien e punës dhe duke bërë kompensimin e të gjitha pagave nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.335/2021

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Jeton KOÇA

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuases, Avokat z.
- Kryetarit të Komunës së Rahovecit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Rahovecit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.